



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS PËR SHKOLLËN E MESME TË GJUHËVE
TË HUAJA (GJIMNAZ GJUHËSOR)**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJUHË ANGLEZE

KODI: 3.1.12.Zgj.(av)

**PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË ANGLEZE
PËR KLASËN E 12-TË**

Koordinatorë: Erifili Hashorva

Redaktore letrare: Vjola Grillo

Përgjegjëse sektori: Marita Hamza

TIRANË, NËNTOR 2010

Programi i gjuhës angleze për klasën e 12-të, i avancuar, për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja, vjen si një risi në praktikën tona kurrikulare. Si i tillë, ai i jep mësimit dhe përvetësimit të gjuhës angleze një rëndësi tejet domethënëse, duke u ofruar nxënësve mundësi reale, të pashkelura më parë, për përvetësimin logjik, të thelluar e praktik të gjuhës angleze. Ai është shprehje e përkushtimit në rritje të shoqërisë sonë ndaj arsimit dhe emancipimit të brezave të rinj për t'u dhënë atyre shanse të barabarta dhe për t'i afruar ata sa më shumë drejt realiteteve të reja të zhvillimit dhe integritit të shoqërisë sonë. Programi ofrohet, gjithashtu, si një domosdoshmëri në rrethanat e reja dhe praktikën e konsoliduara që gjuha angleze ka fituar brenda vendit, si dhe nëpërmjet zgjerimit të dimensionit të saj global. Programi përbën një qasje të re ndaj ndikimit të gjithanshëm të kësaj gjuhe në jetën tonë profesionale dhe atë të përditshme. Ai ka për qëllim të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, të mësimnxënies dhe të vlerësimit të kësaj kategorie nxënësish, në nivelin gjuhësor C1, sipas Kuadrit të Përbashkët European për Gjuhët.

Programi ndërtohet mbi interesat dhe karakteristikat e grupmoshës dhe i kontribuon prirjes dhe angazhimit gjithnjë në rritje të nxënësve për konsolidimin e njohurive bazë të gjuhës angleze, si dhe nevojës që ata kanë për një thellim të aftësive të tyre gjuhësore, teorike dhe praktike në këtë gjuhë. Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë, që ai të rrisë efektivitetin në mësimin e kësaj gjuhe me anë të gërshetimit të marrjes së drejtuar të njohurive, me punën individuale të orientuar, brenda dhe jashtë shkollës.

Programi identifikon dëshirat në rritje të nxënësve për përvetësimin e thelluar të gjuhës angleze dhe veçanërisht atyre që synojnë të maksimalizojnë aftësitë dhe prirjet e tyre të spikatura në këtë gjuhë. Ai promovon ata nxënës që e shikojnë anglishten si një mjet të rëndësishëm për përmbushjen e objektivave të tyre të së nesërme, si një premisë për të qenë të suksesshëm në jetë.

1. SYNIMI I LËNDËS

Programi i avancuar i gjuhës angleze për klasën e 12-të u krijon mundësi nxënësve në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja të thellojnë njohuritë e tyre në përvetësimin e gjuhës angleze, si dhe u krijon mundësi atyre për konsolidimin e nivelit C1. Programi i avancuar i gjuhës angleze për klasën e 12-të synon që nxënësi të zhvillojë më tej arritjet e tij gjuhësore dhe të zbatojë në mënyrë krijuese kërkesat dhe veçoritë specifike të nivelit C1.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Programi i avancuar i gjuhës angleze për klasën e 12-të për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja ka si objektiv të përgjithshëm të ngrejë në një nivel më të lartë mësimin e kësaj gjuhe, si edhe të thellojë më tej e të përafrojë të nxënësit e saj më pranë vendeve anglishtfolëse.

Përdorimi i metodave e praktikave bashkëkohore të mësimit të anglishtes dhe bashkërendimi i strategjive shërbejnë që nxënësi:

- të thellojë më tej pavarësinë dhe individualitetin intelektual dhe kulturor;
- të thellojë më tej njohuritë e marra dhe të nxisë krijimtarinë dhe mënyrën alternative të menduarit;
- të ndërgjegjësohet për veçoritë kulturore të vendeve anglishtfolëse dhe praktikave gjuhësore në kontekste të ndryshme;

- të edukohet me tolerancën, respektin e mirëkuptimin për gjuhët e kombet e tjera.

3. OBJEKTIVA SIPAS STANDARDEVE

a) Objektiva sipas standardit në komunikim

Përshkrimi: Objektivat sipas standardeve për nivelin e avancuar të gjuhës angleze thellojnë më tej bazat e gjuhës dhe përmbajnë një nivel më të lartë gjuhësor komunikimi, i cili kalon nga niveli **B2+ te C1**.

	Objektiva
Komunikimi	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë një paraqitje të një teme komplekse; • të përmbledhë tekste të gjata e të vështira; • të përshkruajë një ngjarje duke sjellë argumente mbështetëse; • të zhvillojë në mënyrë metodike një përshkrim; • të praktikojë strategjitë për bashkëveprim në diskutim; • të shënojë pika të rëndësishme në një përshkrim; • të tregojë interes kur bashkëvepron gojarisht; • të zgjedhë formulimin e duhur në një repertor të gjerë të ligjëratës për të shprehur pa hequr asgjë nga ajo që ai/ajo do të thotë.
Veprimtaritë e komunikimit	<p>Në përfundim të klasës 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë një lajmërim zyrtar pa vështirësi dhe pa sforçime; • të përdorë intonacionin që transmeton nuanca të holla; • të diskutojë rreth lajmeve dhe informacioneve të ndryshme; • të përballojë në mënyrë të përshtatshme vërejtjet; • të praktikojë marrjen e informacionit në telefon; • të bëjë pyetje dhe të miratojë me politesë; • të praktikojë fjalorin që ka lidhje me punën dhe profesionin e tij/saj.

b) Objektiva sipas standardit në kulturë

Përshkrimi: Objektivat e standardeve në këtë fushë parashikojnë një shkallë më të lartë të ndërgjegjësimit kulturor, duke vënë theksin në administrimin e aftësive ligjërimore në ndërveprimin gjuhësor dhe kulturor.

	Objektiva
Kulturë	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë shumicën e emisioneve të lajmeve; • të rrisë njohuritë për gjuhën angleze si një gjuhë botërore; • të mësojë më tepër rreth veprave të rëndësishme dhe shkrimtarëve nga letërsia angleze dhe ajo amerikane; • të kuptojë shumicën e revistave televizive ose një artikull gazete, si dhe çështjet kryesore që trajtohen; • të flasë rreth ndotjes dhe problemeve që kanë lidhje me të; • të njohë folklorin; • të njohë botën akademike; • të njohë stilet artistike; • të njohë burimet e informacionit.

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi: Objektivat e standardit krijojnë mundësinë për të thelluar përvetësimin e elementeve gjuhësore **të nivelit C1**, duke përsosur strukturat e ndryshme gramatikore të gjuhës angleze që arrin nxënësi.

	Objektiva
Elemente gramatikore	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të komunikojë spontanisht, duke kontrolluar mirë gramatikën, dhe me një shkallë formalizmi që u përshtatet rrethanave me anë të përdorimit të saktë të kohës së kryer në të gjitha format e saj; • të përdorë saktë shprehjet frazeologjike; • të thellohet në përdorimin e llojeve të kushtores dhe kushtores së përzier; • të përdorë saktë foljet modale në të tashmen dhe në të shkuarën; • të thellohet në përdorimin e saktë të fjalive të raportuara me modelet e dhëna; • të përdorë me lehtësi fjalitë e përbëra; • të ketë një përvetësim të mirë të shprehjeve idiomatike; • të korrigjojë vetë gabimet gramatikore.

4. OBJEKTIVA SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë me hollësi një ndërhyrje mbi tema të specializuara; • të kuptojë me hollësi atë që i thuhet në një gjuhë standarde; • të reagojë ndaj folësve të ndryshëm të gjuhës standarde për tema të ndryshme; • të shprehë pikëpamjet për pëlqimet e mospëlqimet, si dhe për preferencat e informacioneve të dëgjuara në një program televiziv ose radio; • të kuptojë pa shumë vështirësi emisione televizive dhe filma.
Të lexuarit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë një gamë të madhe tekstesh të gjata dhe me kërkesa, si dhe të kapë domethëniet e pashprehura; • të kuptojë tekste që shprehin fakte ose tekste letrare të ndërlikuara dhe të mund të vlerësojë ndryshimet e stilit; • të kuptojë artikuj të specializuar, duke dalluar faktet nga opinione, si dhe duke identifikuar idetë kryesore, mesazhet etj.; • të identifikojë idenë kryesore të çdo paragrafi në një pjesë të marrë nga një roman ose novelë; • të kuptojë udhëzime të gjata teknike, madje edhe nëse nuk lidhen me fushën e tij/saj.
Të folurit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të bëjë një paraqitje ose një përshkrim të një teme komplekse, duke sjellë argumente mbështetëse dhe duke zhvilluar pikat e veçanta për të arritur në një konkluzion të përshtatshëm; • të shprehet spontanisht dhe lirshëm pa u përpjekur të gjejë fjalët në situata nga më të ndryshmet; • të përdorë gjuhën në mënyrë elastike dhe të efektshme në jetën shoqërore, profesionale ose akademike; • të shprehet mbi tema të ndërlikuara në mënyrë të qartë dhe të strukturuar mirë dhe të shfaqë kontrollin e tij në përdorimin e mjeteve të organizimit dhe të lidhjes logjike të ligjërit; • të japë mendimin e tij për personazhe të pjesëve të ndryshme letrare, për zakonet e ndryshme të vendit të tij

	<p>ose të vendeve të tjera;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të diskutojë për letërsinë, sportet, filmat etj.; • të flasë për të ardhmen e tij/të saj; • të shprehë me saktësi opinionin e tij për situata të mundshme.
Të shkruarit	<p>Në përfundim të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të paraqesë me shkrim, qartë dhe të ndërtuar mirë, një temë të ndërlikuar, esë, raport, duke nënvizuar pikat më të spikatura; • të zhvillojë pikëpamje të ndryshme mbi tema të ndryshme; • të shkruajë mbi tema të ndërlikuara në një letër, esë ose raport duke nënvizuar pikat më të rëndësishme; • të shkruajë letra zyrtare dhe jozyrtare; • të përshkruajë situata të ndryshme nga jeta e përditshme; • të shkruajë paragrafë e hartime të ndryshme me struktura të sakta gjuhësore.

5. KËRKESA TË GJUHËS ANGLEZE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjuha e huaj është një mjet që shërben për të marrë njohuri nga fushat e tjera. Ajo ndërthuret me lëndët e *informatikës, matematikës, historisë, gjeografisë, biologjisë etj.* Kjo çon në rritjen e aftësisë gjuhësore të nxënësit.

Ashtu si në programin për klasën e 11-të, edhe në këtë program një rëndësi e veçantë i është kushtuar integritimit ndërlëndor. Aspekt shumë i rëndësishëm në mësimin e gjuhës së angleze është ai social dhe kulturor. Për këtë arsye duhet pasur parasysh një mësimdhënie e integruar.

Gjuha e huaj mësohet më mirë në kontekste të caktuara, ku fushat tematike të parashtruara në këtë program trajtohen edhe në lëndë të tjera.

Letërsia, njohuritë e së cilës krijojnë një ide shumë të qartë për shkrimtarë dhe poetë të ndryshëm, si edhe për veprat e tyre dhe në këtë mënyrë mësojnë për periudha kohore të ndryshme.

Lidhja me *shkencat natyrore* shprehet në trajtimin e temave të ndryshme që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit dhe ushqimin etj.

Me lëndën e *arteve* janë të lidhura temat për sportin, muzikën etj.

Me *historinë* janë të lidhura ngjarje dhe fakte, të cilat ndihmojnë në formimin kulturor e intelektual të nxënësit, si dhe në njohjen e vlerave historike e shoqërore të popujve anglishtfolës.

Trajtimi ndërlëndor shërben për realizimin e synimeve dhe të objektivave të përgjithshëm të programit për:

Edukimin intelektual: Përmes ndërthurjes së njohurive, nxënësit arrijnë të analizojnë, të sintetizojnë dhe të vlerësojnë, duke rritur cilësinë.

Edukimin mjedisor: Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

Edukimin kulturor dhe etik: Përmes lëndëve historike dhe gjeografike, nxënësit fitojnë njohuri të reja për vendet anglishtfolëse. Këto njohuri ndërthuren me dijet për kulturën e këtyre vendeve, për zakonet e doket e tyre, për mënyrën e jetesës etj. Këtu nuk mund të lëmë pa përmendur edhe shprehjet etike të këtyre popujve.

Edukimin për të drejtat e njeriut: Njohja e kulturave të vendeve anglishtfolëse realizohet e lidhur ngushtë me temat e barazisë sociale, të mosdiskriminimit racial, të respektit reciprok etj.

Atdhdashurinë: Nxënësit ndërgjegjësohen për identitetin e tyre kombëtar, duke njohur kulturat e popujve të vendeve anglishtfolëse. Kjo i mundëson ata që të bëjnë krahasime midis dy kulturave.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i gjuhës angleze të avancuar synon të zgjerojë dhe të thellojë njohuritë e nxënësve. Ky program synon të avancojë aftësitë gjuhësore të nxënësve për qëllime praktike.

A. Objektivat

Objektivat e parashikuar në programin e gjuhës angleze për klasën e 12-të janë të detyrueshëm për t'u realizuar nga mësuesi dhe duhen përvetësuar nga nxënës/i,-ja. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë atë që përshkruhet tek objektivat. Objektivat janë të detyruar të zbatohen sipas shkallës së vështirësisë. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi mësimore dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

B. Orët mësimore

Në këtë program, rreth 70% e orëve mësimore janë për thellimin e njohurive të reja lëndore, kurse 30% janë për përpunimin e njohurive.

Shpërndarja e orëve mësimore

Sipas këtij programi të avancuar për nxënësit e klasës së 12-të, gjuha angleze do të zhvillohet me 2 orë mësimore në javë (**34 x 2 = 68 orë vjetore**) dhe shpërndarja e orëve të planifikuara është si më poshtë:

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 48 orë, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 34 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (70% e tyre, që përbëjnë 24 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 10 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive. Me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni). Aktet dhe funksionet e komunikimit do të jenë 14 orë (70% e tyre, që përbëjnë 10 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 4 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës, d.m.th. ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

Formimi gjuhësor zë 20 orë. Janë kryesisht orë, në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (70% e tyre, që përbëjnë 14 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 6 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin e tyre).

Përpunimi i njohurive

Me përpunim të njohurive kuptojmë rimarrjen dhe përforcimin e informacionit të marrë gjatë trajtimit tematik të përmbajtjes ose ushtrime për rifreskimin ose përsëritjen e strukturave gjuhësore ku nxënës/i,-ja ka shfaqur vështirësi.

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen e njohurive bazë (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e marra;
- integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- përsëritjen vjetore;
- testimin vjetor, i cili nuk është i detyruar.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme:

Kultivimit të aftësive të përgjithshme të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, zgjidhjeve problemore, të menduarit kritik dhe krijues.

Kultivimit të aftësive të posaçme lëndore, si: komunikimi gojor, shkrimi riprodhues e krijues, kuptimi i teksteve me vështirësi dhe gjatësi mesatare, kalimi nga kuptimi thelbësor tek ai më i detajuar, kuptimi me gojë dhe ndërveprimi bisedor etj.

Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe qëndrimi gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Metoda dhe strategji të mësimdhënies/nxënies

Mësues/i,-ja është i/e lirë të përdorë larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/nxënies për t'ua përshtatur nevojave të nxënësve në klasa të ndryshme. Ai/ajo i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënës/it,-es në vijueshmëri të këtij procesi.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën e komunikimit, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe atë të situatave sa me afër jetës reale etj. Këto metoda realizohen nëpërmjet strategjive dhe teknikave të ndryshme, sipas aftësive gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit).

Në këtë nivel gjuhësor zbatohen të gjitha strategjitë për katër aftësitë gjuhësore, por ato përshkallëzohen nga niveli në nivel në varësi të objektivave.

Të dëgjuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime gjatë dëgjimit;
- të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- të përqendrohet e të zbulojë detaje specifike;
- të arsyetojë mbi materialin që dëgjon;
- të përdorë njohuritë e tij/saj të mëparshme;
- të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor;
- të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit;
- të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit.

Të folurit

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- T'i kërkojë folësit të përsërisë atë që sapo ka thënë, në rastet kur nuk e ka kuptuar;
- t'u përgjigjet pyetjeve saktë dhe shkurt;
- të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose shprehje, por të përdorë shprehje e fjalë të njohura;
- të ndërhyjë në një bisedë shkurt dhe me fjali të thjeshta, por me kuptim;
- t'u përgjigjet pyetjeve saktë dhe plotësisht.

Të lexuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të lexojë tekstin për herë të dytë për të hamendësuar kuptimin e fjalëve të panjohura;
- të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme;
- të gjejë në tekst përgjigjet e pyetjeve, duke përcaktuar paragrafin që u përket pyetjeve;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin kryesor;
- të perifrazojë, kur nuk di kuptimin e një fjale të dhënë, pa ndryshuar kuptimin;
- të bëjë bisedë të ndërsjellë me bashkëbiseduesin.

Të shkruarit

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- Të mbajë shënime për informacionin e dëgjuar;
- të planifikojë paragrafët, duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf;
- të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse;
- të plotësojë paragrafë duke përdorur fjalët e munguara.

C. Parime për zbatimin e programit

Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes

Nxënësi duhet të jetë në qendër të procesit mësimor dhe të gëzojë të drejta të plota pjesëmarrjeje duke shprehur përvojën e tij jetësore. Kjo do të realizohet:

Duke përzgjedhur tema, lloje të teksteve dhe forma sociale të orientuara sipas interesave dhe nevojave të moshës së klasës së 12-të, duke pasur parasysh nivelin dhe rezultatet e nxënësve.

Krijimi i mjedisit të të nxënit

Mësuesit tanë duhet të ndërgjegjësohen se është shumë e domosdoshme që nxënësi të ndihet i sigurt. Kjo arrihet nëpërmjet krijimit të një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor, mjedis i cili mundëson një mësimdhënie/nxënie që plotëson ndjeshëm nevojat dhe objektivat e përcaktuar më parë.

Organizimi i klasës

Vendosja e nxënësit në qendër të procesit mësimor do të sjellë ndryshimin e rolit tradicional të mësuesit. Mësuesi do të jetë organizues, furnizues dhe orientues për nxënësit. Ai do t'i ndihmojë nxënësit për një të mësuar të qëndrueshëm. Mësuesi ka më tepër rol planifikues sesa burim i të gjitha njohurive në klasë.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe ajo e situatave sa më afër jetës reale etj.

Mësuesi është i lirë dhe i pavarur në përdorimin e metodave dhe të materialeve mësimore që mbështesin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore si të nxënësve, ashtu edhe të vetë mësuesit.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësimi i anglishtes i drejton nxënësit drejt pavarësisë në rritje në përfitimin gjuhësor, nëpërmjet aktiviteteve përkatëse të të mësuarit, formave të larmishme sociale. Rol të veçantë duhet të zërë puna me grupe, me partnerë. Puna në grupe ndihmon, gjithashtu, në shoqërizimin e nxënësve, i bën ata bashkëveprues me njëri-tjetrin dhe me mësuesit, nxit tolerancën ndaj mendimit të tjetrit, si dhe ndikon në përdorimin e formave demokratike për të ndarë punën dhe përgjegjësitë.

Përdorimi i gjuhës angleze në klasë

Në klasën e 12-të, nxënësi është më i formuar nga ana gjuhësore e kulturore dhe është i gatshëm të përdorë gjuhën angleze në situata reale, si p.sh., në kryerjen e veprimtarive gjuhësore, në dhënien e udhëzimeve për punët e përbashkëta në projekte ku ka ndarje dhe përgjegjësi ndaj detyrave të ngarkuara.

Të mësuarit e gramatikës

Njohuritë gramatikore përbëjnë një objektivi të rëndësishëm të mësimin të gjuhës angleze. Strukturat gramatikore nuk duhet të jepen të izoluara, si qëllim në vetvete,

por në lidhje me aftësitë gjuhësore dhe me përpunimin e temave dhe të kompetencave leksikore. Gramatika duhet të konceptohet përgjithësisht në mënyrë deduktive, me qëllim që të nxiten nxënësit drejt një procesi analitik dhe nga mendimi kritik. Duhet të hiqet dorë nga dhënia paraprake e rregullave dhe tabelave shablloje nga mësuesit. Futja e strukturave të reja gramatikore duhet të bëhet nga vetë nxënësit, nëpërmjet dhënies së shembujve të shumtë dhe të larmishëm.

Korrigjimi i gabimeve

Nxënësit nxiten që të vetëkorrigjohen ose të korrigjojnë njëri-tjetrin dhe të mësojnë prej gabimeve që ata bëjnë. Shpesh mësues/i,-ja dokumenton gabimet e përsëritura dhe, kur është e nevojshme, dhe i korrigjon ato duke përdorur format e sakta gjuhësore.

Puna e diferencuar me nxënësit

Me qëllim që metodat e mësimdhënies/nxënies, parimet dhe strategjitë mbi të cilat realizohen këto metoda të kenë arritje sipas standardeve të përcaktuara, mësuesi planifikon punën e diferencuar me nxënësit.

Duke pasur parasysh përbërjen heterogjene të klasave tona, mësuesi duhet të parapëlqejë punën në grupe. Kështu, ai mund të krijojë grupe të përziera me nxënës/e të përparuar/a dhe të prapambetur/a; duke caktuar detyra në grup për të mos i vënë në vështirësi këta nxënës dhe për t'i inkurajuar të zgjidhin ato detyra që mundën. Mësuesi mund t'u japë gradualisht detyra motivuese e tërheqëse plus nxënësve për të siguruar një nivelim të tyre me të tjerët, por duke bërë kujdes që të mos rrisë vështirësitë e tyre.

Një motivim i mirë për thellimin e njohurive të anglishtes, konkretisht për nxënësit e përparuar, është puna e veprimtarive shtesë, si: përzgjedhje e materialeve autentike, krijime me shkrim në kuadër konkurses, recitime ose vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj etj. Ai mund të përdorë punën e këtyre nxënësve për të realizuar bashkë me ta një aspekt shumë të rëndësishëm të metodologjisë së zbatimit të programit si integrimi lëndor, ku nxënësit e përparuar mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

Si rekomandim, më poshtë paraqiten disa teknika që duhet të përdorë mësuesi për tërheqjen e të gjithë nxënësve në procesin mësimor:

- Të ketë vullnetin dhe dëshirën për t'i dëgjuar dhe për t'u dhënë përgjigje nxënësve;
- të ndjekë klasën në çdo hap, brenda dhe jashtë saj;
- të ndajë përgjegjësitë atje dhe atëherë kur duhet, për çështje vendimmarrjeje, detyra shtëpie apo klase, detyra me shkrim etj.;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej nxënësve vlerësime të punës së tij, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive;
- të shmangë çdo gjë që nuk i përshtatet moshës së nxënësve;
- të zgjedhë materiale për mësim në përputhje me kërkesat dhe standardet e programit mësimor;
- të përpiqet ta mënjanojë diçka që nuk ecën në klasë, dhe të përdorë punën në grup ose, për individë të veçantë, punën individuale;

- të përdorë ushtrime që kërkojnë pjesëmarrje aktive, duke nxitur që edhe nxënësit me dije jo të plota të përfshihen në to;
- të shmangë ushtrime që i vënë këta nxënës në vështirësi dhe i zënë ngushtë;
- të motivojë nxënësin edhe për një detyrë fare të vogël që ka bërë, me qëllim që të rritet dëshira dhe përgjegjësia për mësimin e gjuhës së huaj;
- të mos paragjykojë nxënësit, por, përkundrazi, t'u japë ushtrime që kërkojnë vëmendje dhe punë.

7. VLERËSIMI

Vlerësimi është një element i rëndësishëm i procesit të mësimdhënies/nxënies, pasi përmes tij përcaktohet shkalla e përvetësimit të njohurive, shkathtësive e shprehive gjuhësore të përfshira në program dhe matet efektshmëria e të nxënësve. Ai bëhet në mënyrë sistematike gjatë gjithë procesit të mësimdhënies/nxënies. Mësuesit vlerësojnë përparimin sistematik të nxënësve nëpërmjet pyetjeve, testeve dhe punëve me shkrim, si dhe vëzhgojnë ecurinë e nxënësve në përvetësimin e njohurive, shprehive të të kuptuarit dhe të të shprehurit.

Mësuesi përdor metoda të ndryshme vlerësimi. Me anë të tyre ai siguron që nxënësit të përfitojnë dhe të konsolidojnë njohuritë e përfshira në program. Ai jep detyra specifike me objektiva të menduar mirë për të çuar më tej njohuritë e fituara.

Kontrolli me gojë është një element i rëndësishëm i vlerësimit të arritjeve. Ai motivon dhe rrit vetëbesimin. Gjatë vlerësimit me gojë duhet pasur parasysh përdorimi i strukturave gramatikore, fonetike, leksikore, si dhe rrjedhshmëria.

Kontrollet me shkrim japin një informacion më të plotë për rezultatet e arritura. Testet duhet të jenë realiste, të qarta dhe të matshme.

Vlerësimi motivues kryhet gjatë gjithë procesit mësimor. Kjo realizohet me fjalët: *mirë, shumë mirë* etj.

Vlerësimi i planifikuar bëhet në fund të çdo mësimi përsëritës. Ai bëhet me notë.

Vlerësimi përfundimtar bëhet me notë. Ai finalizon arritjet e objektivave.

Vlerësimi është një element plotësues i vlerësimit nga mësuesi. Kur vlerësimi bëhet i saktë dhe i argumentuar, nxënësit zhvillojnë aftësinë për t'u vetëvlerësuar. Vlerësimi duhet të konsistojë si në nxjerrjen e gabimeve, ashtu edhe në nxjerrjen në dukje të anëve pozitive.

Vlerësim diagnostikues

Ky vlerësim do të realizohet përmes njohjes dhe vlerësimit të arritjeve dhe mangësive, duke i dëgjuar nxënësit të flasin dhe lexojnë, duke vëzhguar të shkruarit e tyre dhe duke analizuar llojet e produkteve të tyre në procesin mësimor. Vlerësimi diagnostikues:

- Jep informacion për efektivitetin e të nxënësve.
- Ndhmon në gjetjen e mënyrës së veprimit në etapën e dytë të të mësuarit.
- Ndhmon në gjetjen e arsyeve të mospërvetësimit të koncepteve.

Vlerësim formues

Nëpërmjet këtij vlerësimi, synohet të theksohet ajo çfarë ka arritur nxënësi gjatë procesit të formimit të njohurive. Ky vlerësim kryhet *në fillim*: për vendosjen e objektivave në procesin mësimor, *gjatë vitit*: për të vlerësuar ecurinë e njohurive të fituara, për përmirësim, si dhe *në fund të vitit*: për të parë se çfarë është arritur.

Më poshtë sugjerohen disa veprimtari ose kërkesa për vetëvlerësimin formues:

- Të shpjegohen objektivat pedagogjike të veprimtarive;

- pas një veprimtarie të bëhet një pushim dhe të bëhet pyetja “Çfarë keni mësuar?”
- t’i kërkohet rregullisht nxënësit të bëjë bilancin e njohurive të ndryshme;
- të shpallen provimet e vlerësimit përmbledhës dhe të përcaktohen paraprakisht kriteret e suksesit;
- të pyeten nxënësit, në një situatë suksesi, “Çfarë bëtë për të pasur sukses?” dhe të nxitën ata të shkëmbejnë përvojën e tyre mbi këtë temë;
- t’i kërkohet nxënësit, pas një krijimi me shkrim, të tregojë çdo gjë për të cilën është i sigurt në tekstin e tij (për shembull, duke nënvizuar);
- t’i kërkohet nxënësit, në rast mëdyshjeje mbi një formë ortografike, leksikore ose morfologjike, ta shënojë këtë formë në tekstin e tij dhe të hartojë pyetjen në fund të faqes në formë shënimi (mësuesi i përgjigjet në të njëjtën mënyrë).

Vlerësim përmbledhës

Ky vlerësim bëhet në fund të një numri temash, njësisish, detyrash e kapitujsh, ose në fund të një periudhe të caktuar kohore.

Vlerësim motivues

Ky vlerësim ka për qëllim të nxisë interesin dhe dëshirën e nxënësve për të mësuar. Vlerësimi i nxënës/it,-es përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitës sesa suksesi i arritur, duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës/e.

Do të inkurajohen nxënësit të njohin procedurat e vlerësimit si mundësi për vetëvlerësim.

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës angleze, ku secili jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësuesi.

Vetëvlerësimi ka efekt kur ai u referohet normave dhe kapacitetit që korniza e gjuhëve parashtron për grupmoshën e tyre, dhe kur ky vlerësim është i lidhur me një përvojë të veçantë, që mund të jetë ajo e kalimit të testeve. Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin e nxënësve në vazhdimësi.

Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli European i Gjuhëve (PEGj), që me anë të tri pjesëve të tij: Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë Gjuhësore dhe Dosjes, nxisin nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore që mund të jenë provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.

Portofoli European i Gjuhëve është dokumenti në të cilin çdo nxënës që mëson ose ka mësuar një gjuhë që mësohet në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe përvojat kulturore. PEGj-i e nxit nxënësin të mësojë më shumë gjuhë,

edhe në nivele modeste, dhe të vazhdojë t'i mësojë gjuhët përgjatë gjithë jetës. PEGJ-i e nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe aftësinë e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. PEGJ-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Europë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kulturave të tjera dhe ndihmës së kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësuesi dhe nxënësit bëjnë komentin përfundimtar.

Nxënësit vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.

Nxënësi mban shënim arritjet e tij, duke përdorur edhe gjuhën amtare.

Mësuesi bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin që ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu të organizojnë më mirë të nxëniet e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënësi, ashtu edhe mësuesi.

Nxënësit do të nxiten të zhvillojnë të menduarit e pavarur dhe vetëdijen për aftësinë e tyre për përmirësime përmes kuptimit të hollësishëm të procedurave të vlerësimit.

Nëpërmjet vetëvlerësimit nxënësit vlerësojnë veten nëpërmjet një pyetësi mbi atë se "*çfarë di të bëj?*".

Vetëvlerësimi është një formë e re, por tashmë mjaft e përhapur në botën arsimore. Ai është pjesë e të mësuarit të pavarur, dhe konsiderohet mjaft i nevojshëm jo vetëm nga nxënësit, por edhe nga mësuesit. Është detyrë e çdo mësuesi të shpjegojë dhe të njohë nxënësit me përmbajtjen e vetëvlerësimit, përdorimi i së cilës do të sjellë ndërgjegjësim të mëtejshëm të problemeve të të mësuarit.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve dhe as vendosjen e notave në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara nga orët e kaluara dhe kryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here, mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të realizuara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon **provime periodike** me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxëniet. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga testet e shkurtra për një objektivi të veçantë të të nxëniet, deri tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe **provimi përfundimtar**.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive

kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, kurse mësuesi është në rolin e atij që drejton, që rekomandon dhe që orienton.